



NR 3107 REP

NR 1394 KOL

### KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot me datën 04.10.2017 (kater tetor dymije e shtatembedhjete),dite merkure, para meje noteres Gentjana A. Dedja, anëtare e dhomës se noterëve Tiranë, Rrethi Gjygjësor Tiranë ,Rruga Skender Luarasi,Godina 19,Pall 4, u paraqitën palët kontraktuese :

#### DHURUESI

XHAFER KODRA atesia Maliq, lindur ne Tresove, Korçe, me 15.09.1952 banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, shtetas shqiptar , per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi Nr 032440193, Nr personal I35308018D, leshuar nga MB dt 08.01.2014.

Ne cilesine e ortakut te vetem me 100% pjese te kuotes pjese te kuotes te Shoqerise “ **READ 2000** ” shpk me seli ne Tirane Njesia administrative nr.5, Rruga "Shkelqim Fusha", Zona Kadastrale 3292, Vol. 734, fq. 88, me nr. Pasurie.104/87-G12 **regjistruar ne QKB, me NIPT L71718029K** , i cili për efekt të kësaj Kontrate do të quhet pala **Dhuruese**.

#### PRANUESI

AFRIM XHYHERI atesia Menduh, lindur ne Vlore, me 11.06.1967, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, shtetas shqiptar , per identitetin e te cilit u sigurova nga leternjoftimi Nr 028441134, Nr personal G70611171L, leshuar nga MB dt 15.02.2010 i cili për efekt të kësaj Kontrate do të quhet **Pranuesi i Dhurimit**.

Në vijim dhe për efekt të kësaj Kontrate, të dy së bashku do të referohen si “Palët” dhe veç e veç si “Pala”.Te lartpermendurit me deshiren dhe me vullnetin e tyre te lire dhe te plote me kerkuan redaktimin e ketij akti si me poshte vijon:

#### Baza ligjore

Në përputhje me nenet 761-771 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenin 73 pika 1/ç, të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, si dhe vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve.

-Dhuruesi **Xhafer Kodra** zotëron 100% pjesë të kuotës së kapitalit të **Shoqërise “READ 2000” Albania** ” shpk, te cilat përbëjnë 100 % të kapitalit të shoqërisë. Ortaku i vetem i kesaj shoqërie, dëshiron t’i transferojë me anë të dhurimit pa kundërshpërblim pranuesit te dhurimit **Z. Afrim Xhvhëri** , **100** % të pjesëve të kuotës që ai zotëron në kapitalin e shoqërisë se lartpermendur .



-Pranuesi i Dhurimit, deklaron se do të pranojë dhurimin e 100 % të pjesëve të kuotës së kapitalit të shoqërisë **Shoqërisë "READ 2000"** shpk.

-Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë lartpërmendur me vendimin e datës 04.10.2017 ka miratuar dhurimin e 100 % të kuotës nga dhuruesi tek pranuesi .

### **Neni 1**

#### **Objekti i Kontratës**

Objekti i kësaj Kontrate Dhurimi, është transferimi nëpërmjet dhurimit nga **dhuruesi** i cili zotëron 100 % pjesë të kuotës së kapitalit të **Shoqërisë "READ"** shpk, të cilat përbëjnë 100 % të kapitalit të shoqërisë tek pranuesi i dhurimit .

### **Neni 2**

#### **Kushtet e Kontratës**

Pas kalimit te ketyre kuotave shoqeria do te kete 1 ortak **Z. Afrim Xhvyheri , me 100% te kuotave.**

### **Neni 3**

#### **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Akt-Marrëveshjeje, mes Palëve, do të zgjidhet me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjellë mes tyre. Në rast të kundërt, Palët do t'i drejtohen gjykatës kompetente.

### **Neni 4**

#### **Shtojcat e kontratës**

Kësaj Kontrate Dhurimi Kuotash, i bashkëngjiten dhe janë pjesë përbërëse e saj:

- Ekstrakti mbi të dhënat e regjistrimit të shoqërisë .
- Kopje e dokumentit të identifikimit të Dhuruesit.
- Kopje e dokumentit të identifikimit të pranuesit.
- Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme te **Shoqërisë "READ 2000"** shpk.

### **Neni 5**

#### **Ligji i zbatueshëm**

Kjo Kontratë Dhurimi hartohet në përputhje me nenet 761-771 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenin 73 të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar. Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë rregulluar në këtë Kontratë do të zbatohen dispozitat e përmendura në paragrafin e parë të këtij neni.



**Neni 6**  
**Hyrja në fuqi**

Detyrimet dhe të drejtat që burojnë nga kjo Kontratë fillojnë efektet e tyre nga momenti i nënshkrimit të saj.

**Neni 7**  
**Legjislacioni i Kontratës**

Palëve iu lexua kontrata , iu shpjegua, u kuptua dhe iu bënë të ditura pasojat ligjore ,dhe pasi e gjetën aktin të redaktuar sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të plotë,e nënshkruan atë pa vërejtje në praninë time.

Ky akt u redaktua nga unë notere **Gentjana A.Dedja** ne katër origjinale te njëjta , ne gjuhën shqipe ,ne baze te nenit 51 të ligjit Nr 7829 dt 01.06.1994 “Për noterinë”nga te cilat njera qendron prane kesaj zyre,nga nje kopje iu jepet paleve kontraktuese dhe njera dergohet ne QKR per te ndryshimet e duhura. Ne baze neni 39 të ligjitNr 7829 dt 01.06.1994 “Për noterinë” vërtetoj nënshkrimin e tyre.

**PALËT KONTRAKTUESE**

**DHURUESI**



**XHAFER KODRA**

Ortak i vetem i shoqerise “ Read 2000” shpk


**PRANUESI I DHURIMIT**

**AFRIM XHYHERI**

**NOTERE**  
**GENTJANA A.DEDJA**




## VENDIM

Nr. 1, datë 04.10.2017

### I ORTAKUT TË VETËM

Sot, më datë 04.10.2017 në selinë e shoqërisë “READ 2000” shpk me seli ne Tirane Njesia administrative nr.5, Rruga "Shkelqim Fusha", Zona Kadastrale 3292, Vol. 734, fq. 88, me nr. Pasurie.104/87-G12 **regjistruar ne QKB, me NIPT L71718029K**, unë ortakut i vetëm i shoqërisë, **Xhafer Kodra** pasi shqyrtova:

#### Rendin e Ditës:

- Transferimin nëpërmjet dhurimit të 100 % të pjesëve të kuotës së kapitalit të shoqërisë;
- Paraqitjen e dorëheqjes si administrator i shoqërisë;
- Emërimin si administrator të vetëm të shoqërisë, Z.Afrim Xhyheri.

Si dhe,

Në përputhje me nenin 73 të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” që parashikon se “1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:...ç) dhurimit.”, dhe nenet 761-771 të Kodit Civil,

#### VENDOSA:

- T’i transferoj Z. Afrim Xhyheri. nëpërmjet dhurimit, pa shpërblim të drejtën e zotërimit aktiv të 100 % të pjesëve të kuotës së kapitalit të shoqërisë “**READ 2000**” shpk .
- Të paraqes dorëheqjen time si administrator i shoqërisë “**READ 2000**” shpk .
- Të emëroj si administrator të vetëm të shoqërisë “**READ 2000**” shpk .  
. Z. Afrim Xhyheri.
- Të autorizoj Z. Z.Afrim Xhyheri. mbajtës i Letërnjoftimit ID me Nr. Personal G70611171L , që në emër dhe për llogari të shoqërisë, të kryejë të gjitha veprimet për depozitimin dhe regjistrimin e këtij vendimi dhe të kontratës për transferimin nëpërmjet dhurimit të kuotave së kapitalit të shoqërisë, që do të lidhet midis meje dhe Z.Afrim Xhyheri., në QKB.

#### ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

“**READ 2000**” shpk P/ligjor **XHAFER KODRA**